



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 nëntor 2022
Nr. ref.:RK 2068/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI71/21

Parashtrues

Naser Sopa

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
REV. nr. 239/2020, të 26 nëntorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Naser Sopa me vendbanim në Kaçanik (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 239/2020] e Gjykatës Supreme të Kosovës, të 26 nëntorit 2020 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar më 1 shkurt 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, përmes të cilit, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 16 prill 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 22 prill 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, anëtarë.
8. Më 27 prill 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 27 prill 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë të dorëzojë një kopje të fletëkthesës për të vërtetuar se kur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, REV. nr. 239/2020, i 26 nëntorit 2020.
10. Më 30 shkurt 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë paraqiti në Gjykatë fletëkthesën për dorëzimin e Aktgjykimit [REV. nr. 239/2020] të Gjykatës Supreme parashtruesit të kërkesës, me datën e dorëzimit 1 shkurt 2021.
11. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullin 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimin e Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
12. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullin 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

13. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit nr. KI71/21, caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu pas dorëheqjes së tij.
14. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit nr. KK 160/21, përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohet kryesuese në kolegjet shqyrtuese në rastet ku është caktuar anëtare e kolegjit, duke përfshirë edhe rastin e tanishëm.
15. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimin e Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
16. Më 22 shtator 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe me shumicë votash i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

17. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 7 tetor 2005, R.S., babai i parashtruesit të kërkesës, si shitës, dhe G.P., si blerës, kanë arritur marrëveshje për shitblerjen e banesës në Prishtinë, në sipërfaqe prej 76 m² (në tekstin e mëtejshëm: paluajtshmëria kontestuese) në pronësi të paraardhësit juridik të parashtruesit të kërkesës.
18. Më 30 dhjetor 2005, parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e kreditorit, paraqiti një kërkesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë për caktimin e masës së përkohshme për ndalimin e shitjes së paluajtshmërisë kontestuese, ku parashtruesi i kërkesës, si bazë për caktimin e masës së përkohshme, thekson ekzistimin e marrëveshjes familjare mbi ndarjen e pasurisë së përbashkët familjare nga prilli 2002.
19. Më 4 janar 2006, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin E. nr. 1418/05 vendosi të caktojë masën e përkohshme dhe të ndalojë shitjen dhe ngarkimin (vënien në hipotekë) e paluajtshmërisë së kontestuar, duke obliguar parashtruesin e kërkesës, si në vijim: *“OBLIGOHET kreditori që në afat prej 30 ditëve të ushtron padi Gjykatës Komunale në Prishtinë, dhe për këtë do ta njoftoj gjykatën duke u thirrur në numrin në të cilin është lëshuar masa e përkohshme. Nëse kreditori ushtron padi në afatin e caktuar masa e përkohshme vlen deri në përfundimin e procedurës kontestimore, në të kundërtën nëse nuk ushtron padi gjykata do ta abrogoj masën e lëshuar dhe do ti ndërpres të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarrimore pa e njoftuar kreditorin me aktvendim të veçantë”*.
20. Më 4 janar 2006, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Themelore në Prishtinë padinë kundër babait të tij R.S. për vërtetimin e pjesës trashëgimore në paluajtshmërinë kontestuese.
21. Më 4 maj 2006, R.S., në cilësinë e shitësit, dhe G.P., në cilësinë e blerësit, nënshkruan Kontratën për shitblerjen e banesës kontestuese, e cila është vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë me numër Vr. nr. 3313/2006.
22. Më 24 maj 2006, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar anulimin e Kontratës së shitblerjes Vr. nr. 3313/2006 të 4 majit 2006, të përpiluar ndërmjet R.S., në cilësinë e shitësit, dhe G.P., në cilësinë e blerësit, për shitblerjen e paluajtshmërisë kontestuese, duke e konsideruar lidhjen e

marrëveshjes së përmendur në kundërshtim me marrëveshjen familjare të vitit 2002 dhe në kundërshtim me masën e përkohshme të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të vendosur me Aktvendimin E. nr. 1418/05, të 4 janarit 2006.

23. Më 7 maj 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin C. nr. 1019/06 refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit në tërësi si të pabazuar, lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me marrëveshjen e pretenduar familjare. Gjykata Themelore arsyetoi se: *“marrëveshja të cilës i referohet paditësi nuk përmban asnjë fakt [...] që të trajtohet si marrëveshje, ngase e njëjta është e hartuar me dorëshkrim i cili për gjykatën është mjaft i paqartë, nuk përmban, respektivisht përcakton asnjë obligim, nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e familjes, e për më tepër mungon vet titullari i pronës, andaj si e tillë nuk ka prodhuar asnjë efekt juridik për palët, pra të drejta dhe detyrime për paditësin dhe te paditurin N.S.”.*
24. Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me faktin se në kohën e lidhjes së Kontratës Vr. nr. 3313/2006 të 4 majit 2006 kanë ekzistuar arsye për pavlefshmërinë absolute të kontratës, përkatësisht kanë ekzistuar masat e përkohshme të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të vendosura me Aktvendimin E. nr. 1418/05 të 4 janarit 2006, Gjykata Themelore ka arsyetuar se: *“Në rastin konkret është fjala për masën e përkohshme me të cilën pretendohet sigurimi i një të drejte, e cila masë është lëshuar në bazë të ligjit procedural (në këtë rast të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore), shkelja e të cilës nuk përfaqëson veprim që është në kundërshtim me ligjin material detyrues në kuptim të nenit 103 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (i cili ka qenë në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës dhe te ushtrimit të padisë në gjykatë)”.*
25. Në një datë të pacaktuar në vitin 2014, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar se aktgjykimi i lartpërmendur i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
26. Më 9 shtator 2019, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin Ac. nr. 4421/14, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke vërtetuar në tërësi Aktgjykimin (C. nr. 1019/16) e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Gjykata e Apelit vlerësoi se kontrata kontestuese e shitblerjes, *“nuk është lidhur në kundërshtim me dispozitat ligjore materiale të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e lidhjes së saj në fuqi, normat e moralit dhe normat e dokeve të mira afariste siç parashihet në dispozitat e nenit 103 të LMD, dhe se masa e përkohshme e cila ishte lëshuar me vendimin e gjykatës së shkallës së parë E. nr. 1418/05, i datës 04.01.2006 e cakton masën e përkohshme me të cilën të ndjerit R.S i ishte ndaluar ngarkimi (vënia në hipotekë) dhe shitja e banesës e cila ka qenë objekt i shitjes sipas kontratës së lidhur në mes të ndjerit R.S si shitës dhe këtu te paditurit G.P. si blerës, nuk përfaqëson bazë ligjore që e njëjta të shpallet si kontratë absolutisht nule. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit masat siguruese të cilat sipas propozimit të palëve në procedurë mund të caktohen nga gjykata, sipas përcaktimit ligjor bërë me dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore shërbejnë, respektivisht çdoherë kanë për qëllim ruajtjen e një gjendje ekzistuese përmes së cilës do të evitohet rreziku rreth pamundësimin dhe vështirësimin të realizimit të kërkesës se palës e cila pretendon se i takon një e drejtë subjektive e caktuar mirëpo në asnjë rrethanë masa siguruese e caktuar lidhur me një send të caktuar, siç në rastin konkret kemi pasur të bëjmë me banesën e cila ka qenë objekt i shitjes sipas kontratës së lidhur në mes të ndjerit R.S. si shitës dhe këtu të paditurit G.P. si blerës, atë send nuk e vë jashtë qarkullimit juridik, me çka nën rrethanën e tillë lënda e kontratës së shitblerjes Vr. nr. 3313/2006, e datës 04.05.2006, ka qenë edhe e lejuar dhe si e tillë ka prodhuar efekt juridik në mes palëve kontraktuese”.*

27. Në një datë të pacaktuar në vitin 2020, parashtruesi i kërkesës parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
28. Më 26 nëntor 2020, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 239/2020, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke vërtetuar në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit.
29. Në pjesën përkatëse të Aktvendimit të Gjykatës Supreme thuhet se: “[...] *Pretendimi kundërshtues në revizion lidhur me atë se objekti i kontestit (banesa lëndore) ka qenë jashtë qarkullimit juridik për shkak të ekzistimit të masës së përkohshme gjë që sipas palës paditëse kontrata e shitblerjes kualifikohet si nule, është pretendim kundërshtues i vlerësuar dhe i arsyetuar nga gjykata e shkallës së parë dhe nga gjykata e shkallës së dytë, të cilat kanë konkluduar se masa e përkohshme e sigurimit në rastin konkret nuk ndikon në nulitetin e kontratës dhe as në mënyrën e vendosjes. Këtë qëndrim për rastin konkret e mban edhe Gjykata Supreme e Kosovës, për shkak se masa e përkohshme e sigurimit shërben si mjet për ta siguruar kërkesëpadinë në kuptimin që po të jetë e themeltë kërkesëpadia e paditësit ajo të mund të realizohet, respektivisht kundërshtari i sigurimit mos ta bëjë të pamundur realizimin e kërkesës, apo mos ta vështirësoj realizimin e saj, por në vetvete fakti se ka qenë e caktuar masa e përkohshme nuk e paracakton nulitetin e kontratës së shitblerjes dhe as mënyrën e vendosjes sa i përket kërkesës bazë dhe asaj alternative në këtë rast. [...] Lidhur me marrëveshjen e paraqitur në dorëshkrim nga paditësi e sipas të cilës pretendon se ka të drejtë të paktën në kërkesën alternative, Gjykata Supreme vlerëson se një marrëveshje e tillë nuk i plotëson kushtet për të prodhuar efekte ligjore sepse nuk është ndjek procedura për formalizimin e marrëveshjes dhe rrjedhimisht nuk janë përcaktuar të drejta dhe detyrimet reciproke. Kjo nënkupton se kërkesa e paditësit ndaj të paditurit N.S., për pagesën e shumë prej 21.250,00 Euro, është e pathemeltë sepse i padituri nuk kishte ndonjë raport detyrimi ndaj paditësit”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me të drejtat dhe liritë e tij themelore të përcaktuara në nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
31. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arsyetuar se si ka ndodhur shkelja e pretenduar e nenit 31 të Kushtetutës, por në parashtrësën e tij ka theksuar se:

“Përkundër ekzistimit të masës me të cilën ndalohej shitblerja e banesës lëndore, ishte lidhur dhe vërtetuar kontrata e shitblerjes VR nr. 3313/2006 me dt. 04.05.2006, pra 5 muaj pas caktimit të masës së përkohshme të sigurisë”.
32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se pas vendosjes së masave të përkohshme nga Gjykata Themelore sipas rekomandimit të tij, *“kishte ushtruar padinë C nr. 10/06, që nënkuptonte se masa ishte në fuqi deri në zgjidhjen e këtij kontesti”.*
33. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon zbatim të gabuar të ligjit, konkretisht se:

“Me rastin e vlerësimit të vlefshmërisë së kontratës së shitblerjes në kohën kur ishte në fuqi ndalesa për shitblerjen e banesës, objekt i kontratës, gjykata ka bërë interpretim të gabuar dhe diskriminues të dispozitës së nenit 103 lidhur me nenin 47 të LMD dhe pa bazë ka refuzuar kërkesëpadinë. Gjendja e fakteve shpiente në të vetmin përfundim se kontrata për shitblerje të banesës ishte në kundërshtim me

dispozitat ligjore që rregullonin lejushmërin e objektit të shitblerjes. Përkundër fakteve të provuara gjykata pa të drejtë përfundon se “kërkesëpadia nuk mund të kualifikohet as në grupin e shkaqeve nga neni 103 e as në atë nga neni 111 i LMD”. Parashtruesi i kërkesës konsideron se zbatimi i së drejtës në rastin e tij është diskriminues me interpretim diskriminues të dispozitave ligjore pasi i mohohet një e drejtë e provuar”.

34. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që ta deklarojë kërkesën e tij të pranueshme dhe ta shpallë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 239/20] të 26 nëntorit 2020 të pavlefshëm dhe ta kthejë çështjen në rivendosje.

Dispozitat relevante ligjore

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i RSFJ-së, i 1 tetorit 1978

[...]

Kreu II

LINDJA E DETYRIMEVE

KONTRATA

[...]

II. Objekti

[...]

Nuliteti i kontratës për shkak të objektit

Neni 47

Kur objekti i detyrimit është i pamundur, i palejueshëm, i pacaktuar ose i cili nuk mund të caktohet, kontrata është nul.

[...]

IV Zotësia

Kontrata e personit të paaftë për të vepruar

Neni 56

(1) Për lidhjen e kontratës së plotfuqishme nevojitet që kontraktuesi të ketë zotësinë për të vepruar që kërkohet për lidhjen e kësaj kontrate.

(2) Personi me zotësi të kufizuar për të vepruar mundet pa lejen e përfaqësuesit të vet ligjor të lidhë vetëm ato kontrata, lidhja e të cilave i lejohet nga ligji.

(3) Kontratat e tjera të këtyre personave janë të rrëzueshme, në qoftë se janë lidhur pa lejen e përfaqësuesit ligjor, por mund të riaftësohen me autorizimin e tij të mëvonshëm.

[...]

V. Të metat e vullnetit

Kanosja
Neni 60

- (1) Në qoftë se pala kontraktuese ose ndonjë i tretë me kanosje të palejueshme ka shkaktuar friksim të bazuar te pala tjetër, kështu që kjo për këtë arsye e ka lidhur kontratën, pala tjetër mund të kërkojë që kontrata të anulohet.
- (2) Frika konsiderohet e bazuar në qoftë se nga rrethanat shihet se nga rreziku serioz është cenuar jeta trupi ose ndonjë e mirë tjetër e rëndësishme e palës kontraktuese ose e personit të tretë.

Lajthimi esencial
Neni 61

- (1) Lajthim është esencial në qoftë se ka të bëjë me veçoritë karakteristike të objektit me personin me të cilia lidhet kontrata në qoftë se lidhet duke marrë parasysh këtë person, si dhe me rrethanat në bazë të të cilave sipas zakoneve që praktikohen ose sipas qëllimit të palëve, konsiderohen vendimtare, ndërsa pala që është në lajthim nuk do ta lidhte përndryshe kontratën me përmbajtje të tillë.
- (2) Për shkak të lajthimit esencial pala në lajthim mund të kërkojë anulimin e kontratës për shkak të lajthimit esencial, përveç në qoftë se gjatë lidhjes së kontratës nuk ka vepruar me kujdesin që kërkohet në praktikë.
- (3) Në rastin e anulimit të kontratës për shkak të lajthimit, pala tjetër e ndërgjegjshme ka të drejtë të kërkojë kompensim për dëmin e pësuar, pavarësisht nga fakti se pala në lajthim nuk është fajtores për lajthimin e vet.
- (4) Pala në lajthim nuk mund ta invokojë këtë në qoftë se pala tjetër është e gatshme ta zbatojë kontratën sikur lajthimi të mos kishte ekzistuar fare.

[...]

Mashtrimi
Neni 65

- (1) Në qoftë se njëra palë shkakton lajthim te pala tjetër, ose e mban në lajthim me qëllim që ta bindë me këtë për lidhjen e kontratës edhe atëherë kur lajthimi nuk është esencial.
- (2) Pala që ka lidhur kontratën duke qënë e mashtruar, ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit të pësuar.
- (3) Në qoftë se mashtrimin e ka bërë personi i tretë, mashtrimi ndikon në vetë kontratën në qoftë se pala tjetër kontraktuese në kohën e lidhjes së kontratës e ka ditur ose është dashur të dinte për mashtrimin.
- (4) Kontrata pa kompensim mund të anulohet edhe kur mashtrimin e ka bërë personi i tretë, pavarësisht nëse pala tjetër kontraktuese në kohën e lidhjes së kontratës e ka ditur ose është dashur të dinte për mashtrimin.

Kontratë fiktive
Neni 66

- (1) Kontrata fiktive nuk ka efekt midis palëve kontraktuese.
- (2) Mirëpo, në qoftë se kontrata fiktive fsheh ndonjë kontratë tjetër, kjo ka fuqi, në qoftë se janë plotësuar kushtet për validitetin e saj juridik.
- (3) Fiktiviteti i kontratës nuk mund të theksohet ndaj personit të tretë të ndërgjegjshëm.

[...]

Pavlefshmëria e kontratës
Nuliteti i kontratave

Nuliteti
Neni 103

(1) Kontrata që është në kundërshtim me parimet e përcaktuara me kushtetutë të rregulimit shoqëror me dispozitat e detyrueshme apo me moralin e shoqërisë vetëqeverisëse socialiste është nul, në qoftë se qëllimi i rregullës së shkelur nuk pasjell ndonjë sanksion tjetër apo në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diçka tjetër.

(2) Në qoftë se lidhja e kontratës së caktuar është e ndaluar vetëm për njerën anë kontrata do të mbetet në fuqi, në qoftë se në ligj nuk është parashikuar diçka tjetër për rastin e caktuar ndërsa pala që e ka shkelur ndalesën ligjore do të pësojë pasoja përkatëse.

[...]

II Kontrata të rrëzueshme

Kur kontrata është e rrëzueshme

Neni 111

Kontrata është e rrëzueshme kur e ka lidhur pala me zotësi të kufizuar për të vepruar, kur gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve, si dhe kur kjo gjë është caktuar në këtë ligj ose me dispozitë të veçantë.

Pranueshmëria e kërkesës

35. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

37. Në vijim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

38. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën në cilësi të palës së autorizuar, duke kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [REV. nr. 239/2020] e Gjykatës Supreme të 26 nëntorit 2020, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

39. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

40. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin [KI04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin [KI220/21](#), parashtrues *Besim Smajli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 26 marsit 2021, paragrafi 46).

41. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi e pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 31 gushtit 2019; pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara,

paragrafët 255 deri në 284; shih gjithashtu rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 27, si dhe rastin [KI220/21](#), cituar më lart, paragrafi 47).

42. Në këtë kontekst dhe në vazhdim, për të vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht në rrethanat e këtij rasti, për të vlerësuar nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 28).
43. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës përsërit të njëjtat argumente që ka paraqitur në procedurat para Gjykatës Themelore dhe të Apelit, se gjykatat e rregullta janë marrë me këtë çështje, kështu që Gjykata do të shtjellojë më tej procedurat para gjykatave të rregullta në paragrafët në vijim.
44. Në këtë kontekst, Gjykata para së gjithash rikujton se rrethanat e rastit kanë të bëjnë me kërkesën e parashtruesit të dorëzuar në gjykatat e rregullta me qëllim të anulimit të Kontratës së Shitblerjes (Vr. nr. 3313/2006) të 4 majit 2006. Kjo kërkesë e parashtruesit u refuzua nga Gjykata Themelore dhe më pas Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme vërtetuan në tërësi vendimin e shkallës së parë, ku gjykatat arritën në përfundimin se kërkesat ligjore sipas dispozitave imperative të së drejtës materiale për anulimin e kontratës nuk ishin përmbushur.
45. Në rastin konkret, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës konsistojnë në *vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin dhe interpretimin e gabuar të ligjit*, me çka ai e ngritë çështjen e zbatimit dhe interpretimit të gabuar të dispozitave ligjore, që bie ekskluzivisht në juridiksionin e gjykatave të rregullta (ligjshmëria).
46. Gjatë shqyrtimit të këtyre pretendimeve, Gjykata së pari thekson se të njëjtat në thelb kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm, të cilat pretendime, Gjykata në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së i konsideron si *“pretendime të shkallës së katërt”*.
47. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së (shih në këtë kontekst, sqarimin në Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara; 2. “Shkalla e katërt”, paragrafët 281 dhe 288), parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të *“kushtetutshmërisë”* dhe *“ligjshmërisë”* dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose me interpretimin dhe zbatimin e gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetute dhe/ose me KEDNJ (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI179/18](#), parashtrues *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; [KI56/17](#), parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; [KI216/21](#), parashtrues *Kujtim Rezniqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 prillit 2022, paragrafi 52).

48. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike apo aplikimin e së drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, e që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në lidhje me këtë, rastin e GJEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, [KI179/18](#), cituar më lart, paragrafi 48; dhe [KI216/21](#), cituar më lart, paragrafi 53).
49. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-së, [Miragall Escolano dhe te tjerët kundër Spanjës](#), nr. 38366/97, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës [KI179/18](#), cituar më lart, paragrafi 72). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlihet me rastet të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar me “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës (për një sqarim më të detajuar përkritazi me konceptin e “*aplikimit të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar*”, shih, ndër të tjera, Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së (aspekti civil), të 31 gushtit 2020, Pjesa IV. Kriteret Procedurale; 3. Shkalla e Katërt; b. Fushëveprimi dhe Kufizimet e Mbikëqyrjes së GJEDNJ-së, paragrafët 329-333; dhe rastin e Gjykatës [KI178/18](#), cituar më lart, paragrafët 74 dhe 75 dhe referencat e përdorura aty).
50. Në këtë drejtim, për t'i shmangur keqkuptimet nga ana e parashtrueseve të kërkesës, Gjykata thekson se “*drejtësia*” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi “*substanciales*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës (shih, rastin [KI131/19](#), parashtrues *Sylë Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 prillit 2020, paragrafi 57; dhe [KI216/21](#), cituar më lart, paragrafët 60 dhe 61).
51. Në terma praktik, më saktë, termi “*drejtësi procedurale*” do të thotë: (i) mundësinë e procedurës kontradiktore/parimi i procedurës kontradiktore; (ii) mundësinë që palët në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesin pretendimet dhe provat të cilat i konsiderojnë si të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) e drejta që argumentet e tyre të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen siç duhet nga gjykatat e rregullta (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së: [Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68, dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese: [KI128/19](#), cituar më lart, paragrafi 58, dhe [KI22/19](#), parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
52. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se në rrethanat e rastit konkret, pretendimet kryesore të parashtruesit kanë të bëjnë me interpretim të gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta. Në thelb, parashtruesi i kërkesës pretendon se *zbatimi i së drejtës në rastin e tij është diskriminues, me interpretim diskriminues të dispozitave ligjore pasi i mohohet një e drejtë e provuar*.

53. Përveç kësaj, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë shqyrtuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me dispozitat ligjore, vërtetimin e gjendjes faktike dhe administrimin e provave.

54. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin [C. nr. 1019/06] të 7 majit 2014, deklaroi si në vijim:

“Nga provat e administruara dhe nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse gjykata ka gjet të vërtetuar faktin se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore që kontrata mbi shitblerjen e banesës me nr. Vr. nr. 3313/2006 e dt. 04.05.2006 e lidhur në mes të R. S. dhe G. P. të vërtetohet se është nule. Kjo për faktin se vlefshmëria e kontratës apo nuliteti i saj vlerësohet në bazë të ligjeve materiale me të cilat është rregulluar e drejta subjektive e cila është objekt i kërkesëpadisë, shkelje të dispozitave kushtetuese ose të moralit shoqëror”.

55. Duke shqyrtuar të njëjtat pretendime, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin [Ac. nr. 4421/14] të 9 shtatorit 2019, parashtrori arsyet për refuzimin e ankesës, duke theksuar si në vijim:

“se kontrata kontestuese del se nuk është lidhur në kundërshtim me dispozitat ligjore materiale të cilat kane qenë në fuqi në kohën e lidhjes së saj në fuqi, normat e moralit dhe normat e dokeve të mira afariste siç parashihet në dispozitat e nenit 103 të LMD, dhe se masa e përkohshme e cila ishte lëshuar me vendimin e gjykatës së shkallës së parë E. nr. 1418/05, i datës 04.01.2006 e cakton masën e përkohshme me të cilën të ndjerit R.S. i ishte ndaluar ngarkimi (vënia në hipotekë) dhe shitja e banesës e cila ka qenë objekt i shitjes sipas kontratës së lidhur në mes të ndjerit R.S. si shitës dhe këtu të paditurit G.P. si blerës, nuk përfaqëson bazë ligjore që e njëjta të shpallet si kontratë absolutisht nule”.

56. Gjykata rithekson konstatimet e Gjykatës Supreme nga Aktgjykimi [Rev. nr. 239/2020] i 26 nëntorit 2020:

“Në rastin konkret kontrata nuk është as në kundërshtim me dispozita ligjore që i referohen rrëzueshmërisë së kontratës sepse me dispozitën e nenit 111 të LMD parashihet se: “Kontrata është e rrëzueshme kur e ka lidh pala me zotësi të kufizuar për të vepruar, kur gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve, si dhe kur kjo gjë është caktuar me këtë Ligj ose me dispozita të veçanta”. Nga dispozita e cituar rezulton se shkaqet të cilat mund të kenë ndikim në cenimin e vullnetit kualifikohen si rrethana që tërheqin rrëzueshmërinë e kontratës, gjë që në këtë rast nuk ekziston sepse shitësi dhe blerësi me vullnetin e tyre të lirë e të shprehur kanë përcaktuar përmbajtjen e raportit juridik civil duke respektuar edhe kushtet ligjore për transferin e titullit të pronësisë. Përveç të cekurave në këtë rast nuk plotësohet as kushti për mungesën e zotësisë për të vepruar, sepse me rastin e shitblerjes palët ishin me zotësi veprimi. Shitja e pronës nga i ndjeri R.S., nuk i plotëson konditat e cenimit të pjesës së domosdoshme në raport me paditësin N.S., sepse cenimi do të nënkuptonte situatën kur shitësi (R.S.) përmes shprehjes së vullnetit të tij të fundit, do të disponon me tërë pasurinë trashëgimore me rastin e caktimit të trashëgimtarit të tij, apo me punë juridike të dhurimit apo të lënies lege të sendeve nga pasuria trashëgimore. Pra cenimi në pjesën e domosdoshme themi se ekziston atëherë, kur vlera e disponimit me testament apo me punë juridike, kontratë të dhurimit, e tejkalon vlerën e parapare me ligj që do të takonte trashëgimtarit të domosdoshëm. Në rastin konkret, shitja e pronës gjatë jetës së tij, nënkupton krijimin e një raporti juridik civil për një kërkesë të disponueshme tërësisht e cila nuk kufizohet nga të drejtat në pjesën e

domosdoshme për trashëgimtarët potencial, prandaj edhe në këtë kuptim kërkesa e paditësit është e pathemeltë”.

57. Lidhur me këtë, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta, në rrethanat e rastit konkret, kanë shqyrtuar dhe arsyetuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, dhe Gjykata gjithashtu vëren se gjykatat e rregullta kanë konstatuar se nuk ka ekzistuar asnjë pengesë ligjore për hartimin e kontratës së shitblerjes, anulimin e së cilës parashtruesi e kërkoi nga gjykatat e rregullta. Gjithashtu, ekzistimi i masës së përkohshme nuk ka pasur ndikim në mënyrën e vendimmarrjes së gjykatave të rregullta, sepse efekti i masës e ka humbur kuptimin për shkak të pabazueshmërisë së kërkesëpadisë së parashtruesit. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se nuk rezulton se procedurat pranë gjykatave të rregullta në tërësinë e tyre kanë qenë të padrejta ose arbitrare.
58. Prandaj, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta të shtjelluara më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij se gjykatat e rregullta mund të kenë *“aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar”*, duke rezultuar në *“konkluzione arbitrare”* apo *“qartazi të paarsyeshme”* për parashtruesin e kërkesës, dhe rrjedhimisht pretendimet e tij për interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit në fuqi, kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e pretendimeve të *“shkallës së katërt”* dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të *“ligjshmërisë”* dhe nuk janë argumentuar në nivel të *“kushtetutshmërisë”*. Për pasojë, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
59. Gjykata gjithashtu rithekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontest civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI118/17](#), parashtrues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 janarit 2018, paragrafi 36; dhe [KI49/19](#), cituar më lart, paragrafi 54; dhe [KI99/19](#), parashtruese *Persa Raičević*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 48).
60. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës për shkak të interpretimit të gabuar dhe zbatimit të gabuar të ligjit të aplikueshëm janë pretendime që kualifikohen si pretendime të *“shkallës së katërt”*; dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit si dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 20 shtator 2022, me shumicë votash

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani